REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 262 /119
Datë/Datum. 30.05.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Nr i prokurimit	**KEK-19-292-1-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKC-19-056-111**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: **N.T.P "SNR"**

Adresa : **Rruga "Ahmet Krasniqi** *Vendi:* ***Prishtinë,*** *Kodi postar:* ***10 000***

Numri Telefonit: **044/593-593**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Fatlum Bajgora**

Adresa elektronike: ntpsnr1@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës: 30.05.19 **Nënshkrim i dhe vula:**

N.T.P. "SNR" PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontrate: 05.02.2019

Afati për dorëzim te tenderit: 28.03.2019

Kriteri i vlerësimit te ofertave : Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 15.05.2019

Njoftimi për OE të pasuksesshëm: 15.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim: 20.05.2019

Përgjigje e AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim : 22.05.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	X

Hapja ne mënyre elektronike- Nuk kemi marre pjese

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			**Jo**	☐

Me datën 15.05.2019 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e pa suksesshëm.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po X **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 20.05.2019 përmes platformës se e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës. Me datën 22.05.2019 përmes platformës se e-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues që e refuzon kërkesën tonë si te pa bazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

Neni 57 : Sigurimi i Tenderit

Neni 59 : Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Nenin 65: Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Neni 29- Sigurimi i Tenderit

Neni 39- Sqarimi i Tenderëve

Shkeljet e dispozitave - F03- Rregullat për Parashtrim te Ankesave

Neni 6 - Pezullimi i aktivitetit te prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 15.05.2019, Autoriteti Kontraktues- ne platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontrate dhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Suksesshëm dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e pa suksesshëm. Sipas këtij vendimi Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik NEWKO BALKAN L.L.C nga Suhareka me çmimin total prej **4,400,683.74 €.**

Me datën 15.05.2019 nga Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar qasje ne dokumentet e tenderit. Nga Autoriteti Kontraktues na është lejuar qasja ne dokumentet e tenderit dhe me datën 16.05.2019 ne ora 14:30 kemi qene ne qasje te tenderit ne lokalet e Autoritetit Kontraktues. Kemi kërkuar kopje te dokumentacionit te tenderit dhe nga AK kemi pranuar dokumentacionin e tenderit ne mënyre elektronike.

Pas shfletimit dhe analizimit të ofertës së Operatorit Ekonomik që Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate, kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues me vendimin qe ka marre për shpërblim me kontrate Operatorin Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C nga Suhareka, ka bere shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik në Republikën e Kosovës pasi që ka shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik i cili ka dorëzuar oferte te pa përgjegjshme.

Oferta e Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C nga Suhareka nuk i plotëson këto kritere të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues:

1. **Kërkesat e përshtatshmërisë: Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit- Aneksi 2.**

Ne paragrafin e pare te Deklaratës shënon:

"Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [*operatorin ekonomik që paraqitet*] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092".

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" se bashku me ofertën ka dorëzuar Deklaratën nen Betim por nuk e ka plotësuar ashtu siç kërkohet ne formën e përcaktuar në Aneksit 2 te dosjes së tenderit. Nuk e ka shënuar emrin e Operatorit Ekonomik që përfaqëson ne paragrafin e pare te Deklaratës. – **Dëshmia 1- shiko Deklaratën nën Betim që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**

2. Siguria e tenderit

Përshkrimi i Nenit 57 te LPP - Sigurimi i Tenderit

1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se:
   1.1. autoriteti kontraktues vendos, duke u bazuar në fakte të verifikuara se tenderuesi në fjalë i ka dhënë autoritetit kontraktues informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese,
   1.2. tenderuesi në fjalë e tërheqë tenderin pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të specifikuar në dosjen e tenderit.
   1.3. tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (i) **që** të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në dosjen **e tenderit**; (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose (iii) që të ekzekutojë një kontratë që përputhet më kushtet e specifikuara në dosjen e tenderit.
2. Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit.

3. Sigurimi i tenderit bëhet në formë të çekut të vërtetuar, letër krediti, garancion bankar ose polisë e sigurimit; sidoqoftë, **autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit të gjitha kushtet – e parapara në rregullat e prokurimit – që duhet ti përmbushë lëshuesi i çekut, letrës së kreditit, garantimit bankar apo polisës së sigurimit.**

Përshkrimi i Nenit 29- - Sigurimi i Tenderit- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-

29.8 AK do të konfiskoj sigurimin e tenderit në situatat e mëposhtme:

1. AK konstaton që OE ka dorëzuar informata të pavërteta ose mashtruese;
2. OE tërheq tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve , por para skadimit skadimit të periudhës se validitetit të tenderit
3. OE fiton kontratën por refuzon ose dështon:
   a. Te ofroj sigurimin e ekzekutimit, siç specifikohet në DT
   b. Të respektoj kushtet tjera që paraprijnë nënshkrimin e kontratës, siç specifikohet ne DT ; ;
   c. Të përformoj kontratën, sipas specifikimeve në DT.

Përshkrim i Nenit 39 - Sqarimi i Tenderëve - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-

Problemi	Si te veprohet	Neni i LPP
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Përshkrimet në Dosjen e Tenderit

Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT
13. Sigurimi i tenderit
13.4 **Forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 4 të kësaj dosje të tenderit.**

Aneksi 4- SIGURIA E TENDERIT- Dosja e Tenderit

Për: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [*emri dhe adresa e operatorit ekonomik*]

(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë

Numri i Prokurimit: KEK-19-292-1-1-1

Garancion me kërkesë te pare

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: *< shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra >* zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit

nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;

c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

- Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
- Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me: *<data dhe koha >*

_____

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

_____

Emri i institucionit financiar

_____

Adresa

_____

Data

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me ofertën ka dorëzuar Sigurimin e tenderit të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, Njësia Prizren me datën 21 Mars 2019.

Sigurim i tenderit që Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ka dorëzuar së bashku me ofertën nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues ashtu siç kërkohen në nenin 57 te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 29. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Kërkesat në Dosje te Tenderit- Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT dhe Aneksit 4 – Sigurimi i Tenderit të bashkangjitur në Dosjen e Tenderit te këtij aktiviteti te prokurimit.

Sigurimi i tenderit që Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ka dorëzuar se bashku me ofertën, është jo valid pasi që i mungojnë shumica e të dhënave të kërkuara në Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Ajo qe është esenciale për mangësitë qe ka ky garancion është se i mungojnë klauzolat e kushteve të konfiskimit te Sigurimit të Tenderit. Kjo e bene Sigurimin e Tenderit te pa realizueshëm për Autoritetin Kontraktues në rast të kërkesës se tij për konfiskim për mospërmbushjen e Operatorit Ekonomik te njërit nga kushtet e specifikuara ne Aneksin 4- Sigurimi i Tenderit dhe legjislacionin e citur me larte. **Dëshmia 2- shiko Sigurimin e Tenderit që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**

Autoriteti Kontraktues- korporata Energjetike e Kosovës, gjate vlerësimit të ofertave në fazën e pare – vlerësimi administrativ, është dashur që ti vëreje këto lëshime substanciale të këtij sigurimi të ofertës dhe kete sigurimin të ofertës ta konsideroje si jo valid , të mos vazhdoj tutje me fazat tjera të vlerësimit të ofertës dhe ofertën e Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ta konsideroje si oferte të pa përgjegjshme dhe ta eliminoj nga aktivitetet i prokurimit.

Dëshmi shtese te cilat dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës, ka bere shkelje substanciale që Sigurimin e Tenderit të Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka e ka konsideruar si valid dhe ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate.

Kemi shfletuar ueb faqen e Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe gjate shfletimit të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese të Prokurimit Publik kemi hasur në Vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr. 373/17 te datës 07.11.2017 ku ka te beje me një rast të njëjtë kur Sigurimi i Tenderit nuk është dorëzuar në harmoni nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit. Një Operator Ekonomik ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit i cili nuk ka

qene në harmoni me nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Autoriteti Kontraktues, automatikisht ketë sigurim të ofertës e ka konsideruar si jo valid, ofertën e ka konsideruar të pa përgjegjshme dhe Operatorin Ekonomik e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Operatori Ekonomik i eliminuar pas refuzimit të kërkesës për Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Eksperti shqyrtues por edhe Paneli Shqyrtues , ankesën e këtij OE e kane konsideruar si të pa bazuar pasi që së bashku me ofertën ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit i cili nuk është sipas nenit 57 te LPP dhe Aneksit 4- te Dosjes se Tenderit. Vlen të theksohet së oferta e Operatorit Ekonomik ankues ka qene mbi **500,000.00 € me e lire** se oferta e Operatorit Ekonomik që Autoriteti Kontraktues e ka shpërblyer me kontrate, por për shkak të mangësive që ka pasur në Sigurimin e Ofertës, është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues dhe ankesa i është refuzuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Gjithashtu me datën 29.05.2019 , Organi Shqyrtues i Prokurimit ka publikuar Vendimin PSH. nr. 184/19. Sipas te dhënave te shënuara ne ketë vendim shihet se një Operator Ekonomik ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit i cili nuk ka qene në harmoni me nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Autoriteti Kontraktues, ketë sigurim të ofertës e ka konsideruar si jo valid, ofertën e ka konsideruar të pa përgjegjshme dhe Operatorin Ekonomik e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Operatori Ekonomik i eliminuar pas refuzimit të kërkesës për Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. **Paneli Shqyrtues , ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues me te drejte e ka eliminuar operatorin ekonomik sepse sigurimi i tenderit i dorëzuar nga ky operator ekonomik në platformën elektronike nuk është dorëzuar në formën e kërkuar nga Autoriteti kontraktues, dhe si i tille nuk përmbushe kërkesën e Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e sigurimit te tenderit sipas Aneksit 4 . Dëshmia 3A dhe 3B- Shiko Vendimin - PSH. nr. 373/17 të datës 07.11.2017 dhe Vendimin e PSH.nr.184/19 të datës 29.05.2019**

4. Deklaratat e kërkuara në Fletën e të Dhënave (FDT) dhe Aneksin 1- Specifikimet Teknike të Detyrueshme

Kërkesat e Autoritetit Kontraktues:

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)

Neni 3.1 i FDT- Specifikacionet teknike të detyrueshme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të

përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Me oferte duhet te dorëzohen edhe këto dokumente:

- Deklaratë e ofertuesit mbi afatin e liferimit prej jo me larg se 40 ditë prej lëshimit të porosisë nga Autoriteti Kontraktues
- Deklaratë mbi afatin e garancionit te shiritit 3 (tre) vite, nga data e montimit në konstruksion.
- Prodhimi i shirtave te behet sipas Standardit DIN:22102 ose ekuivalent

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me ofertën ka dorëzuar:

- Deklaratën e Specifikave Teknike – (Deklarate- Kushtet e Liferimit), por ne ketë deklarate ka shënuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numër: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka dërguar ofertën. Dëshmia 4 - **shiko Deklaratën që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**
- Deklaratën e Liferimit- por ne ketë deklarate ka shënuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numër: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka dërguar ofertën. Dëshmia 5 - **shiko Deklaratën që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**
- Deklaratën e Garanciaonit - por ne ketë deklarate ka shënuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numër: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka dërguar ofertën. Dëshmia 6 - **shiko Deklaratën që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**
- Deklaratën e Standardit DIN:22102- por ne ketë deklarate ka shënuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numër: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka dërguar ofertën. Dëshmia 7 - **shiko Deklaratën që Operatori Ekonomik ka dorëzuar së bashku me ofertën.**

Nga te dhënat e publikuara në Platformën e E-prokurimit, shihet se aktiviteti me numër te prokurimit: **KEK-19-125-121**, ka te beje me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me shirit gome për transporter te zgures.** Dëshmia 8 - **shiko Njoftimin për Nënshkrimin e Kontratës te datës 08.04.2019.**

Nga këto te dhëna shihet se te gjitha deklaratat e shënuara me larte e te cilat i ka dorëzuar Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" se bashku me ofertën për aktivitetin me numër të prokurimit: **KEK-19-292-111,- Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë** janë te pavlefshme dhe nuk i plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Shkeljet që ka bere Autoritetit Kontraktues pas pranimit të Kërkesës për Rishqyrtim dhe dërgimit të vendimit - përgjigjes te OE Ankues

Përshkrim i nenit 6 -Pezullimi i aktivitetit të prokurimit te F03

6.1 Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim **automatikisht pezullon** procedurën e prokurimit dhe ne ketë rast Autoriteti Kontraktues, **respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit**, duhet te njoftoj me shkrim te **gjitha palët e interesuara** lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjale.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës ka bere shkelje substanciale te nenit 6 paragrafi 6.1 te F03- Rregullat për Parashtrim te Ankesave. Pas pranimit te Kërkesës për Rishqyrtim nga kompania jone, fare nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe nuk ka marre asnjë veprim për ti informuar Operatoret Ekonomik lidhur me pranimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Përshkrim i Neni 72 te LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

2- Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Përshkrim -i nenit 39. Sqarimi i Tenderëve te RRUOPP

39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, **ne mënyre objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit te fundit te dorëzimit te aplikacionit apo te dorëzimit të tenderit.** Përveç kësaj, kërkesa nuk do te duhej qe të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.

39.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe **dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se** d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesa te grupeve te OE.

Autoriteti Kontraktues se bashku me Vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim të datës 22.05.2019 na ka dërguar këto dokumente të cilat kane të bëjnë me Operatorin Ekonomik qe AK ka propozuar që të shpërblehet me kontrate- " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka:

- **Letër Standarde e Kërkesës për Sqarimin e Tenderit**, e cila nuk ka date të shënuar së kur është hartuar dhe kur është dërguar të OE;- Dëshmia 9
- **Shkrese – sqarimet** e dërguara nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e datës 24.04.2019; Dëshmia 10
- **Deklarate – Liferimi** e dërguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e datës 24.04.2019- Dëshmia 11
- **Deklarate- Grancioni** e dërguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e datës 24.04.2019- Dëshmia 12
- **Deklarate – Kushtet e Liferimit** e dërguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e datës 24.04.2019- **Deshmia 13**
- **Deklarate Standardet** e dërguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e datës 24.04.2019- Dëshmia 14

Nga këto dokumente te cilat Autoriteti Kontraktues na i ka dërguar se bashku me Vendimin e refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 22.05.2019, shihet se gjate fazës se vlerësimit dhe qasjes në dokumentet e tenderit , Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje substanciale të nenit 10 te LPP, nenit 59 te LPP, nenit 72 te LPP dhe nenit 39 të A01- RRUOPP.

Kur ne kemi qene ne qasje te dokumenteve te tenderit Autoriteti Kontraktues nuk na i ka prezantuar këto dokumente te cilat na i ka dërguar se bashku me vendimin e refuzimit te kërkesës për Rishqyrtim. Kjo dëshmon AK nuk na ka lejuar qasje te plote ne dokumentet e tenderit ashtu siç e lejon nenin 10 i LPP.

Gjate fazës se vlerësimit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtese nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" për dokumente të cilat Operatori Ekonomik se bashku me ofertën veç i ka dorëzuar, por të cilat ju kane referuar një aktiviteti tjetër të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës. Prandaj AK nuk ka pasur te drejte të kërkoj informata sqaruese për diçka që shume qartë ka shënuar në këto dokumente te pranuara së bashku me ofertën– numri i prokurimit- **KEK-19-125-121** e jo ashtu siç është dashur ta shënoje, **KEK-19-292-111.** Numri i prokurimit është shume me rendësi pasi që çdo aktivitet i prokurimit identifikohet përmes numrit te prokurimit të cilin automatikisht e gjeneron platforma e e-Prokurimit për çdo aktivitet te prokurimit.

Dokumentet për të cilat Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë janë kërkesa të te paraqitura ne Aneksin 1 – Specifikat Teknike të Detyrueshme te Dosjes se Tenderit sipas nenit 28 të LPP dhe nuk kane të bëjnë fare me nenin 65 deri 71 te LPP. Bazuar në ketë fakt, Autoriteti Kontraktues sqarimet shtese nga OE i ka kërkuar në kundërshtim me nenin 59 te LPP, nenit 72 te LPP dhe nenit 39 të A01- RRUOPP;

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me sqarimin, me datën **24.04.2019** ka dërguar të Autoriteti Kontraktues: Deklarate – Liferimi, Deklarate- Grancioni, Deklarate – Kushtet e Liferimit dhe Deklarate- Standardet, te cilat kane të shënuara datën **24.04.2019**. Konsiderimi i këtyre Deklaratave si valide nga Autoriteti Kontraktues, është ne kundërshtim te plote me nenin 39.3 i A01- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik. Bazuar ne ketë dispozite asnjë nga dokumentet që nuk dëshmohet se kane ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të tenderit që në ketë aktivitet te prokurimit ka qene data **28.03.2019**, nuk munde të konsiderohen si dokumentacion valid.

Bazuar në të gjitha mangësitë e cekura me larte, shihet se Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës me vendimin që ka marre për të shpërblyer me kontrate Operatorin Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka i cili për ketë aktivitet të prokurimit ka dorëzuar oferte të pa përgjegjshme ka bere shkelje substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të shënuara me larte.

Prandaj , kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të merre për baze ankesën tone për dhe lenden ta ktheje në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës shume voluminoze, shpenzimet e përgatitjes se Kërkesës për Rishqyrtim , shpenzimet e përgatitjes se Ankesës ne Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe fitimet e pritura

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. **Njoftimit për Kontratë- 05.02.2019**
2. **Procesverbali i hapjes se ofertave – 28.03.2019**
3. **Njoftimi për dhënie te kontratës/vendimi i AK : 15.05.2019**
4. **Letër Standarde për Tenderuesin e suksesshëm : 15.05.2019**
5. **Letër Standarde për Tenderuesin e pa suksesshëm : 15.05.2019**
6. **Dëshmia 1- Deklarata nen Betim e dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
7. **Dëshmia 2- Sigurimi i Tenderit i dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
8. **Dëshmia 3A dhe 3B - Vendimi PSH.nr.373/17 i datës 07.11.2017 dhe Vendimi PSH.nr.184/19 i datës 29.05.2019**
9. **Dëshmia 4- Deklaratën e Specifikave Teknike – (Deklarate- Kushtet e Liferimit) e dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
10. **Dëshmia 5- Deklarata e Liferimit e dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
11. **Dëshmia 6- Deklarata e Garanciaonit e dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
12. **Dëshmia 7- Deklarata e Standardit DIN:22102 e dorëzuar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C"**
13. **Dëshmia 8: Njoftimin për Nënshkrimin e Kontratës te datës 08.04.2019.**
14. **Kërkesa për rishqyrtim: 20.05.2019**
15. **Përgjigje e AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim : 22.05.2019**
16. **Dëshmitë e dokumenteve te bashkangjitura: 9,10,11,12,13;14;**
17. **Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se;**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*